



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

DIREKTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRJEVE E SHOQERIVE TE VOGLA DHE TE MESME

Nr. _____ Prot.

Tirane, me 2002



URDHER
Nr. 5 date 24 5 2002

PER

PRIVATIZIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME
"KALDAJA" SH. A DURRES.


Ne baze te nenit 4 te Ligjit Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me ligjet perkatese, dhe Ligjit Nr.8334 date 23.04.1998 "Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike", ndryshuar me ligjet perkatese, si dhe ne zbatim te Vendimit Nr.119 date 18.3.2000 te Keshillit te Ministrave "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike", me cilesine e zoteruesit te aksioneve te shoqerise

Urdheroj :

1. Te privatizohen nepermjet shitjes ne ankand, me leke, 30.866 aksione, me vlere nominale 1000 leke aksioni , qe zoteron shteti, e barabarte ne mase me 44.25% te kapitalit te shoqerise anonime "Kaldaja" sh.a Durres, sipas percaktimeve ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.119 date 18.3.2000.
2. Privatizimi I aksioneve ne perputhje me piken 1 te ketij Urdheri te perfundoje brenda afateve ligjore ne fuqi.

Dhoma e Noterise Tirane
Nr. 472REP/19.05.2004
Vertetohet njesia me originalin.
Gentiana Shkodra
Notere

Gentiana Shkodra



MINISTRI

Ermetinda MEKSI

Ermetinda Meksi



A 27

Dhoma e Noterise Tirane
Nr. 1231 REP 27.05.2003
Vertetohet njesia me originalin.
Gentiana Shkodra

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTER _____



Nr. ~~1231~~ Regj. Nr. ~~1231~~ Kol.

Tirane, me 9.12 2002.

KONTRATE

PER SHITJEN (TRANSFERIMIN) E PAKETES SHTETERORE TE AKSIONEVE PREJ 44,25 % (dyzet e kater presje njezet e pese %) TE "Kaldaja" S.H.A. DURRES

Sot, me date 09.12 2002 (dymije dy), ditën e Hënë, në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit Tirane, përpara meje noterës së Dhomes së Noterise Tirane, Z. G. Shkodra, hartohet kontrata e shitjes së paketës së aksioneve prej 44,25 % e barabartë me 30 866 (tridhjetemije e teteqind e gjashtedhjetë e gjashtë) aksione të "Kaldaja" Sh.A.Durres, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.21538 Akt. date 22.06.1999, ndryshuar me Vendim Nr.21538/1 Akt, date 22.06.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, ndryshuar me Vendim Nr.21538/2 Akt, date 30.11.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, ndryshuar me Vendim Nr.21538/3 Akt, date 09.11.2001,

midis paleve të cilat rane dakord si me poshte :

Neni 1 - Palet

1.1 *Pala shitese:* Agjencia Kombetare e Privatizimit Tirane e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjthshem i saj, **Z. Zihni BEQIRAJ**.

1.2. *Pala blerese:* **Zoti Arben Shehu**, i biri Rebaniut, i lindur me 01.03.53, banues në Durres, me numer pasaporte 0242570, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, i identifikuar me mumur pasaporte _____, i shpallur fitues në ankandin e zhvilluar date 12.07.2002 në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit si dhe mbas njoftimit të "Kaldaja" Sh.a., Durres me Shkresën Nr. extra Prot., date 18.07.2002, i njohur me autorizimin Nr.3535 Prot., date 26.07.2002 të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, për kryerjen e pagesës së vlefës së plote të paketës shtetërore të aksioneve prej 44,25 % të "Kaldaja" Sh.a., Durres.

Neni 2 - Objekti i kontrates

Objekt i kesaj kontrate eshte shitja (transferimi) e 44.25 % te aksioneve e barabarte me 30 866 (tridhjetemije e teteqind e gjashtedhjetë e gjashtë) aksione të zoteruara nga Shteti



Shqiptar, perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise, ne "Kaldaja" Sh.a.Durres, me vlere 30 870 000 (tridhjetemiljon e teteqind e shtatedhjetemije) leke.

Neni 3 - Cmimi i shitjes.

- 3.1. Cmimi i shitjes se paketes se aksioneve prej 44,25 % te zoteruar nga shteti ne shoqerine "Kaldaja" SH.A.Durres eshte 30 870 000 (tridhjetemiljon e teteqind e shtatedhjetemije) leke, vlere e realizuar ne ankandin e dates 12.07.2002 ne Agjencine Kombetare te Privatizimit dhe paguar plotesisht nga pala blerese ne Banken e Kursimeve Tirana 2, ne favor te Agjencise Kombetare te Privatizimit, numri i llogarise 4302 (Dega e Thesarit Tirane).
- 3.2. Pala shitesese deklaroi se ne favor te saj eshte derdhur e gjitha shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate bazuar ne Mandat arketimi Nr. BE 481927 date 02.08.2002 per 9 259 800 (nentemiljon e dyqind e pesedhete e nentemije e teteqind) leke dhe mandat arketimi Nr. BE 518530 date 22.08.2002 per 21 611 000 (njezetemiljon e gjashteqind e njembdhjetemije) lek, leshuar nga Banka e Kursimeve. Vlefte totale e paguar nga pala blerese eshte 30 870 000 (tridhjetemiljon e teteqind e shtatedhjetemije) leke.

Neni 4 - Kushtet e shitjes

- 4.1. Pala blerese gjykohej se ka njohuri te plota per paketen e 44.25 % te aksioneve qe eshte publikuar per shitje, me cmimin e ofruar ne ankand nga kjo pale, ditën e zhvillimit te ankandit.
- 4.2. Pala blerese ka plotesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shitesese ne autorizimin Nr.3535 Prot, date 26.07.2002 (dymije e dy).
- 4.3. Pala blerese pas nenshkrimit te kesaj kontrate, noterimit te saj behet pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe mund te lindin ne lidhje me regjistrimin e kesaj pakete aksionesh prej 44.25 % e barabarte me 30 866 aksione qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.
- 4.4. Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia prej 44,25 % e aksioneve e barabarte me 30 866 aksione te Sh.A. "Kaldaja" Durres transferohet nga Ministria e Ekonomise tek Zoti Arben Shehu, ne perputhje me objektin e kesaj kontrate.

Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e blesesit

- 5.1. Blesesi ka pranuar blerjen e paketes shteterore prej 44.25 % te aksioneve te Sh.A. "Kaldaja" Durres sipas proces-verbalit te zhvillimit te ankandit dhe akt marreveshjes se nenshkruar per kushtet e privatizimit te paketes se aksioneve date 12.07.2002 zhvilluar ne Agjencine Kombetare te Privatizimit si dhe te Shkreses Nr. extra Prot., date 18.07.2002 te "Kaldaja" Sh.a Durres.

sefer
Fajza Haxhi
Luana Pasqaru
2
12.07.02

5.2. Bleresi fiton te drejten e pronese mbi paketen prej 44,25 % te aksioneve te kesaj shoqerie pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.

5.3. Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me rregjistrimin e kesaj kontrate shitjeje. Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronese ne emer te vet.

5.4. Pas nenshkrimt te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per rregjistrimin e pasurive te paluajteshme", pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajteshme te Rrethit Durres.

Neni 6 -Te drejtat dhe detyrimet e shitesit.

6.1. Pala shitesese garanton bleresin per pronesine e plote dhe te ligjshme te shtetit mbi paketen prej 44.25 % te aksioneve te S.H.A. "Kaldaja" S.H.A.Durres, te ofruara per blerje pales blerese.

6.2. Pala shitesese garanton bleresin per perputhjen e kesaj kontrate me frymen e legjislacionit civil ne Republiken e Shqiperise si dhe te drejtat ligjore te bleresit ne lidhje me pronesine mbi kete objekt kontrate perballe organeve gjyqesore ne rast kontestimi te kontrates , kur kjo kerkohet

Neni 7 -Baza ligjore per lidhjen e kontrates

1. Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
2. Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991;
3. Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992;
4. Ligji Nr. 8334, date 23.04.1998
5. VKM.Nr.119, date 18.03.2002;
6. Udhezimi i VKM. Nr.119, date 18.03.2000;
7. Aktmarrveshja nenshkruar midis paleve dite e zhvillimit te ankandit date 12.07.2002;
8. Urdheri i Ministrit te Ekonomise Nr. 5, date 24.05.2002;
9. Shkresa Nr. extra Prot., date 18.07.2002 e "Kaldaja" S.H.a. Durres.

Neni 8 - Dokumentat ligjore qe i bashkengjiiten kesaj kontrate

8.1.Urdheri i Ministrit te Ekonomise Publike e Privatizimit, Nr.5, date 24.05.2002, per privatizimin e paketes prej 44.25 % te S.H.A" Kaldaja" Durres me nje flete.

8.2.Autorizimi Nr.3535 Prot., date 26.07.2002, per kryerjen e pageses se vleres se plote te paketes se aksioneve prej 44,25 % te S.H.A., "Kaldaja" Durres jeshuar nga Agjencia Kombetare e Privatizimit me dy flete.



Agjencia Kombetare e Privatizimit
17.08.2002

8.3. Shkresa e Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit derguar Agjencise Kombetare te Privatizimit me Nr.1489 Prot., 24.05.2002 me nje flete fotokopje e noteruar.

8.4. Genplani i shoqerise se bashku me akt vleresimin e truallit.

8.5. Shkrese Nr.321 Prot. Date 03.12.2002 se bashku me harten treguese te shoqerise derguar nga ZRPP Durres.

8.6. Akt-marveshje date 12.07.2002 nenshkruar midis paleve ne kete kontrate ditën e zhvillimit te ankandit, me nje flete.

8.7. Shkresa Nr. extra Prot date 18.07.2002 e "Kaldaja" Sh.a Durres.

8.8. Mandat arketimet e pageses se paketes shteterore te aksioneve.

Neni 9 – Te ndryshme

9.1. Kjo kontrate iu lexua gojarisht paleve. Kjo kontrate, me kerkesen e paleve perpilohet ne 4 (katere) kopje ne gjuhen shqipe me nga 4 faqe, prej te cilave nje kopje qendron ne Zyren e Noteres, nje kopje ne arshiven e Agjencise Kombetare te Privatizimit, nje kopje i dergohet Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Durres dhe nje kopje i jepet pales blerese.

9.2. Pala shitesë pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te saj te lire e te plote, po keshtu edhe pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te saj te lire e te plote. Ne kete moment palet e nenshkruan kontraten ne pranine e noterit pa asnje pretendim. Une noterja , ne baze te Ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per shitjen e paketes se aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerite anonime e vertetoj ate sipas ligjit.

PALET KONTRATUESE

PALA SHITese

AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT

ZIHNI BEOTIRAJ

DREJTOR I PERGJITHSHEMTAKP.

PALA BLERESE

ARBEN SHEHU

Arben Shehu

NOTER

GENTIAN SHKODRA

Gentian Shkodra

Arben Shehu
Gentian Shkodra
20.07.02